



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

PAKETË INFORMUESE PËR LUKSEMBURGUN

1. Informacioni bazë

Kryeqyteti:	Luksemburg
Popullsia:	0.5 milion
Sipërfaqja:	2,586 km ²
Monedha:	EUR
Niveli i papunësisë:	4.7%
Gjuha:	Letzeburgesch, gjuha kombëtare, është e ngjashme me gjermanishten. Gjermanishtja është gjuha e parë e huaj për shumicën e popullit të Luksemburgut. Frëngjishtja është gjuha administrative.

2. Viza për të vizituar Luksemburgun – Informacion i Përgjithshëm

Më përjashtim të Kroacisë, të gjithë shtetasit e vendeve të Ballkanit perëndimor (Shqipëri, Maqedoni, Mal i Zi, Serbi) kanë nevojë për vizë për të hyrë në Luksemburg. Një vizë bën të mundur që të qëndroni në vend më shumë se 90 ditë për një periudhë gjashtë mujore, duke filluar nga dita e parë e hyrjes.

Llojet e vizave

Autoritetet e Luksemburgut mund të lëshojnë katër lloje vizash. Lloji i vizës tregohet në vizën pullë në një seksion të veçantë dhe shënohet me shkronjat A, B, C ose D.

Vizë transiti në aeroport - A

Kjo vizë bën të mundur që të huajt, të cilëve u kërkohet vizë, të qëndrojnë në zonën ndërkombëtare të transitit në aeroport ndërsa janë në pritje të fluturimit tjetër, por nuk i lejon të hyjnë në vend. Shtetasit e Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kroacisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë nuk kanë nevojë për vizë transiti në aeroport (A).

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Ndërtimi i Kapaciteteve, Informacion dhe Ndërgjegjësim për Promovimin e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme/Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees



GOVERNMENT
OF LIECHTENSTEIN

Vizë transit - B

Kjo vizë i jep të drejtën një të huaji që udhëton nga një vend në tjetrin të kalojë transit nëpërmjet territorit të Shengenit. Një vizë transit mund të nxirret vetëm nëse i huaji provon që ai ose ajo lejohet të hyjë në vendin tjetër të destinacionit pas qëndrimit të tij ose të saj në territorin e Shengenit. Një vizë transit mund të jepet për të kaluar një ose dy herë transit dhe, në raste të veçanta, për të kaluar shumë herë transit, me kushtin që asnjë kalim transit nëpërmjet vendit të mos kalojë numrin e ditëve të përcaktuara në kohëzgjatjen e seksionit të qëndrimit të vizës pullë. Vizat transit me ligj nuk mund të kalojnë 5 ditë.

Vizë afatshkurtër - C

Kjo vizë i jep të drejtën një të huaji të hyjë dhe të qëndrojë në territorin Shengen për turizëm, biznes, vizita personale apo qëllime të tjera për hyrje. Një vizë afat-shkurtër mund të jepet për një, dy ose më shumë hyrje në vendin ku as një qëndrim i vetëm i pandërprerë, as kohëzgjatja kolektive e numrit të qëndrimeve të njëpasnjëshme nuk i kalon 90 ditë brenda një periudhe gjashtë mujore, duke filluar nga dita e hyrjes së parë.

Përgjithësisht nevojiten dokumentet e mëposhtme:

- një pasaportë e vlefshme të paktën tre muaj pas datës tuaj të planifikuar për nisje;
- një formular aplikimi dhe një ose më shumë fotografi të kohëve të fundit;
- dokument që tregon qëllimin e qëndrimit;
- akomodim i konfirmuar;
- fonde të mjaftueshme për të mbuluar koston e qëndrimit;
- një biletë fluturimi për t'u kthyer.

Shqyrtimi i aplikimit mund të kërkojë një muaj ose më shumë, kështu që duhet të planifikoni duke pasur këtë parasysh.

Bazuar në Marrëveshjet për Lehtësimin e Vizave dhe në Marrëveshjet e Ripranimit ndërmjet BE-së dhe **Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë**, shtetasit e këtyre vendeve duhet të kërkojnë vizë C Shengen për të hyrë në Luksemburg; megjithatë ata përfitojnë një tarifë të reduktuar vize (35 Euro në vend të 60 Euro). Shumë kategori të aplikantëve (familjarë të shtetasve rezidentë të ligjshëm, studentë dhe pensionistë, gazetarë etj) tani mund të marrin gjithashtu viza falas. Për kategori të caktuara personash p.sh. tregtarë, studentë dhe gazetarë, kërkesat për dokumentacion do të thjeshtohen. Disa kategorive të personave që udhëtojnë shpesh (përfshirë këtu tregtarë, gazetarë, studentë, përfaqësuesi të shoqërisë civile) do t'u jepen viza me shumë hyrje për periudha të gjata vlefshmërie dhe mbajtësit e pasaportave diplomatike do të përjashtohen nga detyrimi për vizë.

Vizë afatgjatë

Për qëndrim mbi 90 ditë, shtetasit e vendeve që nuk janë në BE /ZEE duhet të aplikojnë për vizë afatgjatë në konsullatën apo ambasadën përkatëse. Vizat nuk mund të merren apo ndryshohen kur të jeni në Luksemburg. Për të aplikuar për një vizë afatgjatë, do t'ju duhet të keni pasaportë të vlefshme për të paktën tre muaj pas vitit të parë të datës së planifikuar të mbërritjes si dhe disa ose të gjitha dokumentet e mëposhtme:

- një certifikatë personale dhe përkthimin e saj për çdo anëtar të familjes;
- fotokopje të certifikatës së martesës apo divorcit të shoqëruar me përkthim, nëse keni;
- një certifikatë mjekësore nga një doktor i miratuar (konsullata apo ambasada do t'ju japë një listë);
- formularin/formularët e aplikimit të plotësuar;
- fotografi pasaporte (një deri në gjashtë ose më shumë sipas rrethanave);

- një leje pune (nëse planifikoni të punoni) ose vërtetim që punëdhënësi juaj ka aplikuar për leje pune për ju;
- vërtetim që pranohet për të ushtruar zanatin në vend (nëse jeni i vetëpunësuar, gazetar ose në një profesion tjetër të rregulluar) ose një kartë profesionale që shërben si leje pune për zanat vetëpunësimi;
- dëshmi penaliteti (ndonjëherë quhet "vërtetim për sjellje të mirë");
- vërtetim i burimeve financiare (nëse nuk do të filloni punë);
- vërtetim i sigurimeve shëndetësore
- si student, vërtetim që jeni pranuar nga një institucion i miratuar arsimor

Vini re që Luksemburgu në përgjithësi kërkon që të keni leje punë ose vërtetim që punëdhënësi juaj ka aplikuar në emrin tuaj përpara se të aplikoni për një vizë afatgjatë apo leje qëndrimi. Aplikimet për vizë afatgjatë zakonisht kërkojnë të paktën tre muaj që të miratohen dhe mund të zgjasin më shumë. Një vizë afatgjatë njihet si leje qëndrimi i përkohshëm ((*autorisation de séjour provisoire*).

Ku të aplikoj

Në ambasadën ose konsullatën në vendit tuaj të origjinës (ose vendin e qëndrimit).

Meqenëse në Shqipëri, BH, Maqedoni dhe Serbi nuk ka misionet diplomatike të Luksemburgut, duhet t'i drejtoheni ambasadave dhe konsullatave të Belgjikës ose Holandës për të marrë vizë për në Luksemburg, si më poshtë:

Në Shqipëri

Ambasada e Holandës

Rruga Asim Zeneli nr. 10, Tirana

Telefon: (+355) 4 240828/839

Faqe interneti: <http://www.mfa.nl/tir-en/>

E-mail: TIR@minbuza.nl

Orari i punës: Nga e hëna në të premte nga ora 09.00 - 12.00. Seksioni i vizave: Nga e hëna në të enjte nga ora 09.00 - 12.00. Seksioni konsullor është i hapur nga e hëna në të enjte nga ora 9.00 deri në orën 12.00.

Aplikimet për vizë mund të dorëzohen vetëm pas caktimit të një takimi. Takimet mund të lihen me telefon: (+355) 4 2259 176 nga e hëna në të enjte, nga ora 9.00 deri në orën 10.00.

Në Bosnjë Hercegovinë

Ambasada e Holandës në Sarajevë

Grbavicka 4, 71000 Sarajevo

Bosnia-Herzegovina

Telefon: (+387) (0)33 562 600

Faqe interneti: <http://www.netherlandsembassy.ba/>

E-mail: sar@minbuza.nl, sar-ca@minbuza.nl

Në Maqedoni

Ambasada e Holandës

Leninova 69-71, 1000 Skopje

Telefon: +389 91 129-319/+389 2 3109-250

Faqe interneti: <http://www.nlembassy.org.mk/>

Email: nethemb@mt.net.mk, SKO@minbuza.nl

Orari i punës: Nga e hëna në të premte nga ora 8:00 deri në orën 4:30, aplikimet për vizë nga ora 9:00 deri në 11:30 në Seksionin Konsullor, nga ora 1:00 deri në 2:00 për kërkesat për vizë me telefon

Në Kosovë

Ambasada e Belgjikës

<http://www.diplomatie.be/pristina/>

Taslixhe I, 23 A
Pristina - Kosovo
Tel +381 (0)38-734.734
Email: pristina@diplobel.fed.be

Në Mal të Zi

Nga janari 2008, aplikantët për vizë A, B dhe C nga Mali i Zi duhet të paraqesin aplikimin e tyre në ambasadën sllovene në Podgoricë, ndërsa aplikantët për vizë D dhe D+C (viza kombëtare: më shumë se 90 ditë) duhet të paraqesin aplikimin e tyre në ambasadën belge në Beograd.

Në Serbi

Ambasada e Belgjikës

<http://www.diplomatie.be/belgrade/>

Krunska, 18 (ex Proleterskih Brigada) 11000 Beograd

Tel: (00.381.11) 32.30.016 (viza); (00.381.11) 32.30.017 (viza); (00.381.11) 32.30.018; (00.381.11) 32.47.587

Seksioni konsullor

Nga e hëna në të premte: nga ora 08h00 – 12h00; nga ora 14h00 – 15h30 (ose me takim)

Seksioni i vizave

- Me takim – aplikimet për vizë mund të dorëzohen të:

Hënë, martën, mërkurën, enjten nga ora 09h00 deri në 12h00.

- Pa takim – për të dorëzuar dokumente shtesë, për të marrë pasaportat:

Çdo ditë pune (edhe të premtën) nga ora 12h00 deri në 13h00

Përjashtimet për vizë

- Shtetasit që udhëtojnë në përputhje me instrumente ligjore të mbrojtjes ndërkombëtare (OKB ose BE « *Laissez-passer* », dokumentin (*titre de légitimation* të dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, vërtetim nga NATO....)
- Nëse keni një dokument udhëtimi për refugjatë sipas Konventës së Gjenevës të lëshuar nga: Gjermania, Belgjika, Danimarka, Spanja, Irlanda, Islanda, Italia, Lihtenshtain, Norvegjia, Holanda, Portugalia, Rumania, MB, Suedia, Zvicra.
- Nëse jeni pjesë e një liste akademike të përcaktuar nga një shtet anëtar i BE-së për të udhëtuar në Luksemburg
- Nëse keni autorizim për qëndrim në ndonjë nga vendet e Shengenit si dhe një dokument të vlefshëm udhëtimi

Kujdes: Disa prej këtyre dokumenteve nuk njihen nga të gjitha vendet e Shengenit. Nëse jeni i detyruar të kaloni transit nga ndonjë vend tjetër Shengen për të hyrë në Luksemburg, duhet të informoheni mirë nga autoritetet e këtij shteti për vlefshmërinë e dokumentit tuaj të udhëtimit.

Për më shumë informacion shihni Departamentin e Imigracionit në Ministrinë e Punëve të Jashtme: <http://www.mae.lu/mae.taf?IdNav=1298>

3. Migracioni për qëllime punësimi

Kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të punëtorëve të huaj

Shtetasit nga vende që nuk kanë në BE duhet të kenë një leje pune, zakonisht për të cilën aplikon punëdhënësi i tyre të mundshëm (që duhet të kërkojnë miratimin nga zyra lokale e punës ose punësimit për t'ju pajtuar juve), për të patur ligjërisht të drejtë të punoni në vend.

Lejet e punës

Luksemburgu përgjithësisht kërkon që të keni leje pune ose vërtetim që punëdhënësi juaj ka aplikuar për një të tillë në emrin tuaj përpara se të aplikoni për leje qëndrimi ose vizë afatgjatë.

Dokumentet e mëposhtme duhet të sigurohen për të aplikuar për leje pune:

- Formular aplikimi
- Fotokopje e noterizuar e pasaportës
- Fotokopje e noterizuar e të gjitha diplomave përkatëse profesionale
- Letër shpjeguese nga punëdhënësi i ardhshëm që konfirmon punësimin
- CV-në tuaj
- Fotokopje të noterizuar të kontratës së punës

Të gjitha dokumentet duhet të dërgohen nga punëdhënësi tek shërbimi publik i punësimit në Luksemburg (ADEM-<http://www.adem.public.lu/demandeur/permis/index.html>) që rezervon të drejtën për të kërkuar ndonjë dokument shtesë gjatë shqyrtimit të aplikimit. ADEM më pas i dërgon dosjen një komisioni të specializuar për një rekomandim që i dërgohet Ministrisë së Punëve të Jashtme, Drejtorisë së Imigracionit <http://apollo.etat.lu/pls/telbook/telbook.bookdep?idMin=5402>.

Procesi i vendimit zgjat nga 4 deri në 8 javë.

Pas marrjes së një letre konfirmimi, aplikanti duhet të aplikojë për vizë në Ambasadën e Luksemburgut të vendit të tij/saj të qëndrimit ose ambasadën belge në vendet ku Luksemburgu nuk është i përfaqësuar drejtpërdrejt.

Rekomandohet që aplikimi për lejen e punës të dorëzohet disa muaj përpara planifikimit tuaj për të filluar punë. Ministria e Punës dhe Punësimit kërkon dokument që tregon se një punëdhënës është përpjekur të gjejë një shtetas të BE-së për pozicionin dhe mund të paraqesë kandidatët e tij nga listat vendore të papunësisë.

Rregulla të përgjithshme të lejeve të punës nuk vlejnë për raste të **vetëpunësimit** për të cilat duhet të merrni leje nga Ministria e Bizneseve të Vogla (*Ministère des Classes Moyennes*). Për të marrë leje, duhet të dorëzoni dokumentacion në lidhje me themelimin e biznesit ose ngritjen e kompanisë apo ortakërisë, një përmbledhje të kualifikimeve profesionale që keni dhe një vërtetim për aftësi paguese që tregon jo vetëm që mund të jetoni me biznesin tuaj, por që keni jetuar me këtë biznes dhe në një vend tjetër. Do të duhet të aplikoni përsëri për lejen e biznesit nëse ndryshon natyra e biznesit tuaj. Kushtet e hyrjes së tyre renditen në fletën e informacionit të publikuar në faqen e internetit të Ministrisë.

Autorizimi është i vlefshëm për një vit dhe i rinovueshëm nëse biznesi ka mundur të japë të ardhura të mjaftueshme.

Lejet e qëndrimit

(Shihni Seksionin 5 më poshtë)

Sektorët e tregut të punës që kanë mangësi

Sektorët që përjetuan një rritje të menjëhershme në 5 vitet e fundit janë:

- Shërbimet tregtare
- Shëndeti dhe mirëqenia sociale
- Financat
- Ndërtimi
- Transporti dhe komunikimi

Prandaj në këto sektorë punë kërkuar kanë mundësi më të mira për të gjetur punë. Ka një numër të madh të pozicioneve të kualifikuara që duhen plotësuar në sektorin financiar. Edhe pse me rritje më të ngadaltë, sektori i hotelarisë dhe shërbimit katering ofron mundësi të mëdha punësimi.

Informacion specifik në lidhje me kualifikimet e kërkuara në disa sektorë gjendet në faqen e internetit www.fedil.lu/Publications, ku mund të shkarkoni broshura të ndryshme (në frëngjisht) për:

- kualifikimet e së ardhmes në industri, ndërtim dhe punë publike;
- kualifikimet e së ardhmes në fushën e ICT (teknologjive të informacionit dhe komunikimit)

Kërkimi i punës

Të gjeni punë në Luksemburg mund të mos jetë aq e vështirë sa e bëjnë statistikat, por kërkon përvojë, disa kualifikime, shumë këmbëngulje dhe pak fat.

EURES

<http://www.europa.eu.int/eures/home.jsp?lang=en&langChanged=true>

Rrjeti i Shërbimit Europian të Punësimit (EURES) përfshin të gjitha vendet e BE-së si dhe Norvegjinë dhe Islandën si anëtarë. Shtetet anëtare shkëmbejnë rregullisht informacion për vende vakante pune dhe zyrat lokale EURES kanë akses informacioni për aplikimet për punë dhe kushtet e jetesës dhe të punuarit. Departamenti ndërkombëtar i shërbimit të punësimit të vendit tuaj mund të t'ju lidhë me një nga Euro-këshilltarët që do t'ju këshillojë për gjetjen e një pune në Luksemburg. Euro-këshilltarët mund të dërgojnë gjithashtu të dhënat tuaja tek shërbimi kombëtar i punësimit të vendit ku jeni i interesuar.

Shërbimi publik i punësimit në Luksemburg

<http://www.adem.public.lu/demandeur/index.html>

ADEM (Administration de l'Emploi) është një vend i përsosur për të filluar kërkimin për punë, pasi shumica e punëdhënësve vendosin shumicën e vendeve të tyre vakante tek ata. Përveç afishimeve të vendeve të punës, ADEM ofron trajnime gjuhe për të huajt (falas sipas rrethanave të caktuara nëse kërkon një punë).

Faqja e Internetit të Çështjeve Europiane:

http://www.eurobrussels.com/job_search.php

Jobs.lu:

www.jobs.lu

Monster.lu:

www.jobsearch.monster.lu

4. Studimi në Luksemburg

Studentët e huaj që dëshirojnë të ndjekin karrierë akademike në një institucion të lartë arsimor në Luksemburg duhet të kontaktojnë institucionin ose titullarin akademik që kanë zgjedhur. Informacion i përgjithshëm për studime në Luksemburg mund të gjenden në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit dhe Trajnimit Profesional (<http://www.men.public.lu/>) ose të Ministrisë së Kulturës, Arsimit të Lartë dhe Kërkimit (<http://www.mcesr.public.lu/>), si dhe një listë të institucioneve të rëndësishme.

Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të studentëve

Të gjithë shtetasit e huaj nga vende që nuk janë në BE/ZEE të cilët planifikojnë të vijnë në Luksemburg duhet të sigurojnë dokumentet e nevojshme që lidhen me qëllimin e vizitës së tyre, dokument që provon se kanë mjeteve të mjaftueshme për të jetuar dhe për t'u strehuar. Në disa raste viza është e nevojshme. Për vizë duhet të kërkon përpara nisjes nga konsullata e Luksemburgut në vendin tuaj të origjinës. Për më shumë informacion: vizitoni Ministrinë e Punëve të Jashtme (Drejtoria e Imigracionit) <http://www.mae.lu/mae.taf?IdNav=3&IdLang=UK>.

Kushtet për vizë të përcaktuara në seksionin 1 më sipër vlejnë për studentë gjithashtu (një vizë afatshkurtër lejon studentin të qëndrojë në Luksemburg deri në 90 ditë dhe një vizë afatgjatë lejon studentin të qëndrojë deri në një vit). Si student, duhet të dorëzoni një letër nga shkolla, kolegji apo universiteti që konfirmon pranimin tuaj së bashku me të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme për vizën përkatëse.

Me vizë studenti nuk ju lejohet të punoni me kohë të plotë. Mund të bëni një praktikë me pagesë apo punë të papaguar për më pak se 20 orë në javë.

Një vizë studenti nuk mbulon bashkëshortin/bashkëshorten apo fëmijën. Nuk mund të sponsorizoni dikë tjetër për të ardhur në Luksemburg.

Viza e studentit është e vlefshme deri në një vit dhe mund të rinovohet për gjithë kohëzgjatjen e studimeve.

Bursa universitare dhe pasuniversitare

Informacioni gjendet në Ministrinë e Kulturës dhe Arsimit- Qendra e Dokumentacionit dhe Informacionit për studime universitare dhe pasuniversitare CEDIS (shihni në seksionin për "financimin"):

http://www.cedies.public.lu/financement/aides_pour_etudes_superieures/index.html

Të huaj që kanë jetuar deri në 5 vjet në Luksemburg si dhe refugjatët përfitojnë ndihmën financiare të siguruar nga CEDIES.

Lista e universiteteve dhe kolegjeve kryesore

Universiteti i Luksemburgut

www.uni.lu

Për informacion si student i huaj vizitoni:

http://www.uni.lu/formations/flshase/bachelor_en_sciences_sociales_et_educatives_bachelor_professionnel/mobilite/mobilite_entrante

Universiteti i Luksemburgut ofron diploma universitare, diploma Master, doktoraturë dhe kurse të tjera të veçanta. Universiteti i ri tani kombinon ish Qendrën Universitare (Centre Universitaire), një institut teknologjie ((Institut Supérieur de Technologie – IST), një institut ndërkombëtar (Institut Universitaire International) dhe dy institute për trajnimin e mësuesve (the Institut Supérieur d'Etudes et de Recherches Pédagogiques – ISEEP dhe Institut de Formation pour Educateurs et Moniteurs – IFEM).

Këto institucione ofrojnë një larmi kursesh, nga programet e nivelit universitar të vitit të parë dhe të dytë në diploma teknike katër vjeçare në inxhinieri industriale. Institutet dy vjeçare për trajnimin e mësuesve janë të specializuara për trajnimin e mësuesve për sistemin arsimor të Luksemburgut dhe programet e tyre janë të hapura vetëm për shtetasit e Luksemburgut. Ka programe pasuniversitare në drejtësi, ekonomik dhe studime europiane që janë të hapura për komunitetin ndërkombëtar dhe një kurs pasuniversitar në të drejtën europiane.

Secili prej programeve të ndryshme ka kërkesat e tij (për shembull, duhet të keni një diplomë pasuniversitare në drejtësi për t'u pranuar në programin për të drejtën europiane) dhe të gjitha nivelet e larta kërkojnë një certifikatë për përfundimin e suksesshëm të shkollës parauniversitare (gjimnazit) ekuivalente me atë që jepet në shkollat në Luksemburg.

Instituti Ndërkombëtar Universitar i Luksemburgut

http://www.iuil.lu/index.php?level1=0&level2=1&level3=0&level4=0&co_group_id=1&fidlanguage=1&lang=en

Instituti Ndërkombëtar Universitar i Luksemburgut (IUIL) i themeluar në 1974 është pranë Ministrisë së Kulturës, Arsimit të Lartë dhe Kërkimit dhe ndodhet në *Château de Munsbach* në Munsbach.

Objektivat e tij kryesore janë promovimi i trajnimit pasuniversitar dhe profesional në fusha të së drejtës komunitare, medias dhe komunikimit, kujdesit të shëndetit publik dhe ekonomisë duke marrë parasysh karakteristikat specifike ekonomike dhe shoqërore dhe asetet e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

Universiteti Zemra e Shenjtë

<http://www.shu.lu/pages/home.php>

Shihni seksionin e veçantë për të huajt: http://www.shu.lu/pages/3_060_living.php

Shumica e programeve të arsimit të lartë kërkojnë zotërim shumë të mirë të frëngjishtes dhe gjermanishtes, edhe pse disa prej programeve dhe seminareve më të shkurtra zhvillohen në anglisht. Për më shumë informacion për arsimin e lartë në Luksemburg, kontaktoni the Département de l'Enseignement supérieur, Ministère de la Culture, de l'Enseignement supérieur et de la Recherche, 20 Montée de la Pétrusse, 2273 Luxembourg (Tel. 0478-6633) ose faqen e internetit të Universitetit të Luksemburgut.

5. Qëndrimi

Ministria e Punëve të Jashtme- Drejtoria e Imigracionit është përgjegjëse për të shqyrtuar aplikimet për leje qëndrimi. Mund të kontaktoni:

Ministère des Affaires étrangères et de l'Immigration
Direction de l'Immigration
12-16, avenue Monterey
L – 2163 Luxembourg
Tel.: (+352) 247-84040

Shtetasit nga vendet që nuk janë anëtare në BE të cilët planifikojnë të qëndrojnë më shumë se tre muaj në vend duhet të kërkojnë një 'carte d'identité d'étranger' [kartë identiteti për shtetas të huaj] brenda tre ditëve të mbërritjes, në komunën ku duan të jetojnë. Pastaj duhet të shkojnë në Departamentin e Imigracionit të Ministrisë së Punëve të Jashtme për të marrë një permis de séjour [leje qëndrimi].

Për leje mund të aplikohet nga ambasada ose konsullata përkatëse përpara mbërritjes në Luksemburg.

Vërtetim pune apo mundësi studimi në Luksemburg duhet të paraqitet.

Leja jepet në parim për një kohë pesë vjeçare; mund të jepet për një afat më të shkurtër nëse rrethanat e kërkojnë dhe kur korrespondon me kohëzgjatjen e parashikuar të qëndrimit brenda Dukatit të Madh. Është e rinovueshme me kërkesë dhe mund të rinovohet menjëherë për një kohëzgjatje kohore maksimale prej 5 vjetësh.

6. Azilkërkues dhe refugjatë

Dorëzimi i aplikimit

Sipas ligjit për azilin, një i huaj mund të dorëzojë një aplikim për azil ose në kufi, ose pasi të hyjë në vend. Në praktikë, shumica e aplikimeve dorëzohen brenda vendit nga aplikantë që kanë kaluar një nga kufijtë tokësore të Luksemburgut. Të gjitha aplikimet duhet t'i dërgohen Zyrës së Pritjes së Refugjatëve në Ministrinë e Drejtësisë.

Pas regjistrimit të çështjes dhe hapjes së një dosjeje nga Zyra e Pritjes së Refugjatëve, aplikanti dëgjohet- përgjithësisht po atë ditë- nga një anëtar i policisë ("polic gjyqësor") për të qartësuar identitetin e tij/saj, rrugën e ndjekur të udhëtimit dhe deklaratat e tij/saj fillestare. Anëtarët e rritur të njëjtës familjes zakonisht intervistohen veçmas.

Në teori, ndihma ligjore është e mundur gjatë intervistës së parë, megjithatë kjo nuk ndodh pothuajse kurrë. Përkthyesit sigurohen nëse është e nevojshme.

Pas intervistës me policinë, azilkërkuetit i jepet një certifikatë që konfirmon regjistrimin e aplikimit, që është e vlefshme për një muaj dhe duhet të rinovohet çdo muaj deri në fund të procedurës së azilit.

Pas intervistës të parë, përgjegjësia e policisë gjyqësore "police judiciaire" është të verifikojë identitetin e aplikantit, rrugën e ndjekur të udhëtimit dhe të konfirmojnë vërtetësinë e deklaratave të tij/saj. Nëse është e nevojshme, mund të intervistojnë aplikantin dhe një herë dhe nëse është e nevojshme në faza të më vonshme të procedurës. Ata gjithashtu mund t'i marrin shenjat e gishtërinjve, sidomos nëse identiteti i tij/saj nuk është i qartë.

Nëse nuk trajtohen sipas dispozitave të Konventës së Dublinit aplikantëve u kërkohet të marrin pjesë në një intervistë me një nëpunës të Ministrisë së Drejtësisë. Kjo intervistë mund të zhvillohet ndërmjet dy ditëve dhe disa muajve pas regjistrimit të aplikimit, edhe pse koha mesatare e pritjes është tre muaj.

Gjatë kësaj interviste të detajuar, aplikanti mund të ndihmohet nga një përkthyes dhe/ose avokat të paguar nga shteti. Në fillim të intervistës, azilkërkueti duhet të vihet në dijeni për të drejtën e tij/saj për ndihmë ligjore. Nëse ai/ajo dëshiron këtë ndihmë, intervista shtyhet në një datë të mëvonshme, në mënyrë që të caktohet një avokat nëpërmjet sistemit pa pagesë të ndihmës ligjore. Aplikantë që kanë kërkuar ndihmën e një përkthyesi dhe/ose avokati kanë të drejtë të mos flasin nëse përkthyesi dhe/ose avokati nuk janë të pranishëm.

Gjatë kësaj interviste, aplikantit i kërkohet të japë një shpjegim të hollësishëm të rrugës së tij të udhëtimit për në Luksemburg, situatën në vendin e tij/saj të origjinës dhe arsyet pse ai/ajo kërkon azil. Intervistuesit përdorin një pyetësor standard që përshtatet sipas shtetësisë së aplikantit dhe rrethanave individuale. Përsëri, anëtarët e rritur të të njëjtës familjes zakonisht intervistohen veçmas.

Pranueshmëria/procedura qartësisht e pabazuar

Nëse Luksemburgu është caktuar si shteti përgjegjës, aplikimi do të trajtohet sipas një procedure para-shqyrtimi për të përcaktuar nëse aplikimi është i papranueshëm, qartësisht i pabazuar, ose nëse duhet të pranohet sipas procedurës normale të vendimit.

Sipas ligjit për azilin, një aplikimin mund të konsiderohet i papranueshëm për arsyet e "vendit të tretë të sigurt". Një "vend i tretë i sigurt" është përkufizuar një vend ku azilkërkueti:

- i dhënë tashmë mbrojtje ose ka pasur mundësinë të kërkojë për mbrojtje të tillë përpara se të kërkonte azil në Luksemburg;
- është mbrojtur kundër kthimit prapa sipas kushteve të Konventës së Gjenevës dhe trajtohet në përputhje me kritere humanitare të pranuar në nivel ndërkombëtar;
- nuk do t'i nënshtrohet ndonjë forme përndjekjeje dhe kur siguria e tij/saj dhe liria nuk kërcënohen

Sipas ligjit për azilin, një aplikim mund të konsiderohet qartësisht i pabazuar kur azilkërkuesi nuk shpreh frikë nga përndjekja për arsyë të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të veçantë social apo mendimeve politike, ose kur ai/ajo rrjedh nga një vend që konsiderohet "i sigurt" nga autoritetet e Luksemburgut.

Vendimi nëse një aplikim është i papranueshëm ose qartësisht i pabazuar merret nga Ministri i Drejtësisë që ka mundësinë të paraqesë rastet e veçanta për mendim ose këshillim tek Komisioni Konsultativ i Refugjatëve ("*Commission Consultative des Réfugiés*") – i përbërë nga një përfaqësues i Ministrisë për Çështje Familjare, një person i caktuar me këshillimin e UNHCR-së dhe një gjyqtari që vepron si kryetar.

Sipas ligjit për azilin, vendimi i ministrit duhet të merret brenda dy muajve të dorëzimit të aplikimit, edhe pse jo më përpara zhvillimit të intervistës së detajuar me nëpunësin e Ministrisë së Drejtësisë (që mund të kërkojë më shumë se dy muaj). Në praktikë, koha që kërkohet për të shqyrtuar një aplikim nëpërmjet papranueshmërisë/ procedurës qartësisht të pabazuar ndryshon nga rasti në rast, por përgjithësisht e kalon afatin kohor dy muajor.

Një azilkërkues brenda tre muajve pas marrjes së një vendimi negativ mund të dorëzojë një kërkesë tek Ministria e Drejtësisë për rivlerësim të rastit të tij/saj.

Ai/ajo mund të paraqesin një ankim për anulim në Gjykatën Administrative brenda një muaji pas marrjes së një vendimi negativ. Ky ankim ka efekt pezullues. Gjykata brenda një muaji tjetër duhet të japë një vendim (dhe në shumicën e rasteve ndodh kështu). Vendimet negative të Gjykatës administrative mund të apelojnë më tej në Gjykatën Administrative të Apelit ("*Cour d'appel administrative et fiscale*") me efekt pezullues. Pas ndryshimeve të ligjit për azilin të marsit 2000, Gjykata e Apelit duhet të marrë vendim brenda një muaji.

Si Gjykata Administrative ashtu dhe Gjykata Administrative e Apelit shqyrtojnë vetëm ligjshmërinë e vendimit të Ministrit dhe jo meritat e çështjes. Nëse vendimi i parë përmbysset, aplikimi i kthehet ministrit për rishqyrtim. Nëse ministri konfirmon vendimin e tij/saj të parë, zakonisht azilkërkuesi largohet nga vendi, nëse ai/ajo nuk është i pranueshëm për ndonjë formë tjetër për leje qëndrimi.

Asistenca sociale

Azilkërkuesit, ashtu si refugjatët dhe personat sipas Konventës nën mbrojtje të përkohshme, kanë të përfitojnë nga Departamenti Social i Komisionit të Qeverisë për të Huajt ("*Commissariat du Gouvernement aux Etrangers*" – CGE). Ky përfitim përfshin ndihmë financiare, akomodim dhe pagesa për shpenzime mjekësore, si dhe kurse gjuhe dhe informacion për aspekte të ndryshme të jetës në Luksemburg. Në fushën e OJQ-ve, Departamenti i Refugjatëve i Karitasit ndihmon azilkërkuesit dhe refugjatët gjatë dhe pas procedurës.

Sapo të ketë regjistruar aplikimin në Zyrën e Pritjes së Refugjatëve në Ministrinë e Drejtësisë, azilkërkuesit dërgohen në CGE ku bëhet intervista me një punonjës social për të vlerësuar nevojat e tyre përsa i përket akomodimit, mbështetjes bazë dhe kujdesit shëndetësor.

Me të mbërritur, meshkujve që janë vetëm mund t'u sigurohet akomodim i menjëhershëm në strehë për personat e pastrehë, përfshirë këtu strehën e pritjes së kryeqytetit Luksemburg ose strehën e natës të Karitasit. Gjatë kësaj periudhe, familjet zakonisht akomodohen në bujtina ose në konvikte. Ky lloj akomodimi i menjëhershëm sigurohet pa pagesë përveç rasteve kur azilkërkuesit kanë mjetet e tyre financiare.

Akomodimi në qendrat e pritjes kufizohet në tre muaj pas dhënies së statusit të refugjatit. CGE përpiqet të vendosë disa refugjatë në të ashtu quajtura "qendra pritjeje të fazës së dytë" ku u jepen dhoma me qira rregullisht për tre vjet. Në janar 2000, kishte 25 nga këto qendrat e fazës së dytë. Refugjatët zakonisht priten të kontribuojnë në qira sipas numrit të dhomave në dispozicion, edhe nëse detyrohen apo jo të ndajnë tualetin apo kuzhinën me familje të tjera, dhe burimet e tyre. Në përgjithësi kontributi është shumë i vogël.

CGE ndihmon këta refugjatë që nuk janë akomoduar në qendrat e pritjes së fazës së dytë për të gjetur vende me qira dhe mund t'i ndihmojë gjithashtu që të paguajnë qiranë. Gjithashtu, Shërbimi i Karitasit për Refugjatët, në bashkëpunim me organizatën Wunnengshwlllef ka mundur të sigurojë rreth 20 apartamente për refugjatët.

Liria e lëvizjes

Autoritetet vendore i pajisin refugjatët sipas Konventës që jetojnë në zonën e tyre me kartë identiteti për të huajt fillimisht të vlefshme për pesë vjet. Refugjatët sipas Konventës janë të lirë të udhëtojnë brenda dhe jashtë vendit.

Ndihma financiare

Ashtu si shtetasit, refugjatët sipas Konventës mbi 25 vjeç që plotësojnë kushtet e kërkuara kanë të drejtë të marrin të Ardhurave mujore Minimale të Garantuara (GMI)

Ndërsa shqyrtohet aplikimi i tyre për GMI- pra për një periudhë rreth dy muaj- refugjatët akoma mund të marrin ndihmë nga CGE për azilkërkuesit. Sapo të jetë paguar GMI, kjo ndërpritet dhe refugjatët trajtohen sipas dispozitave të sistemit të mirëqenies kombëtare.

Megjithatë, refugjatët që nuk kanë burimet e tyre ose që kanë burime të pamjaftueshme, për shembull sepse nuk i përmbushin kushtet për të marrë përfitim papunësie ose GMI, mund të marrin ndihmë financiare nga CGE sipas nevojave dhe burimeve të tyre. Ndihamat që u jepen refugjatëve janë përgjithësisht të njëjta me ato që u jepen azilkërkuesve. CGE ka të drejtë të pakësojë apo rrisë këto ndihma sipas përpjekjeve të bëra nga çdo individ për integrim në Luksemburg.

Refugjatët sipas Konventës kanë gjithashtu të drejtë për përfitim amësie, përfitim për fëmijë dhe pagesa për arsimimin, njësoj si shtetasit. Këto ndihma paguhen në mënyrë retrospektive nga data e mbërritjes në vend, por brenda një kufiri prej një viti. Në parim, ndihamat e paguara nga CGE gjatë procedurës zbriten nga ato që jepen, por CGE mund të mos ë bëjë këtë zbritje për të mbështetur integrimin.

7. Bashkimi Familjar

Refugjatët, persona që janë në mbrojtje të përkohshme ose që janë autorizuar të qëndrojnë për arsye humanitare

Refugjatët, sipas praktikës administrative kanë të drejtë për bashkim familjar me bashkëshortët dhe fëmijët e tyre të mitur. Ribashkimi me fëmijë mbi 18 vjeç dhe me prindërit, mund të lejohet gjithashtu nëse ata janë në ngarkim të refugjatit që jeton në Luksemburg. Në parim, të mitur të pashoqëruar që qëndrojnë në Luksemburg nuk kanë të drejtë ribashkimi me familjet e tyre, pasi mendohet që i mituri duhet të bashkohet me prindërit e tij jashtë.

Ribashkimi nuk është i kushtëzuar me kohëzgjatjen minimale të qëndrimit, por refugjati që jeton në Luksemburg duhet të jetë në gjendje të tregojë ku strehohet si edhe burimet e mjaftueshme. Megjithatë, ndryshe nga të huajt të tjerë që nuk janë nga vendet e BE-së, refugjatët që marrin të ardhura mujore minimale të garantuara (ndihmë sociale bazë) konsiderohet se plotësojnë kushtin e dytë.

Personave të cilëve u është dhënë Mbrojtje e Përkohshme u lejohet gjithashtu ribashkim familjar me bashkëshortin/bashkëshorten dhe fëmijët e tyre të mitur, sipas ligjit të 18 marsit 2000 që ndryshon ligjin për azilin.

Ata me Autorizim për të Qëndruar për Arsye Humanitare kanë të drejtë bashkimi familjar me të njëjtat kushte si imigrantët e tjerë që nuk janë nga vendet e BE-së. Mbjatësit e statusit duhet të kenë leje pune të tipit B që të konsiderohen mjaftueshëm të siguruar përse i përket financave për të ftuar familjen e tij/saj. Kjo leje mund të jepet pasi mbajtësi të ketë pasur lejen A për një vit. Aplikanti duhet të ketë strehimin e nevojshëm dhe mjete për mbështetje financiare.

Procedura: aplikimet për bashkim familjar duhet të dorëzohen në Ministrinë e Drejtësisë nga persona që qëndrojnë në Luksemburg. Ministria është përgjegjëse për dhënien e lejeve të qëndrimit për anëtarët e familjes. Në rast refuzimi, aplikanti mund të paraqesë një kërkesë për anulim në Gjykatën Administrative dhe mund të ankohet më tej në Gjykatën Administrative të Apelit nëse Gjykata Administrative konfirmon refuzimin.

Statusi i personave të ribashkuar: anëtarët e familjes të ribashkuar me një refugjat marrin statusin e refugjatit nëse e kërkojnë këtë status. Në të kundërt u jepet statusi i punëtorëve imigrantë dhe një leje qëndrimi, përgjithësisht e vlefshme pesë vjet dhe e rinovueshme. Rregullimet e udhëtimit për në Luksemburg për anëtarët e familjes mund të organizohen nga organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM) me kërkesë të Komisionit të Qeverisë për të Huajt, që do të mbulojë shpenzimet.

Kategori të tjera të Migrantëve

Kushtet dhe të drejtat për bashkimin familjar nuk përcaktohen me ligj. Në vend të kësaj, ato përcaktohen ose më marrëveshje dypalëshe ose rast pas rasti. Kjo mundëson që bashkimi familjar të bëhet në një hapësirë pothuajse pa ligj, duke e lënë Ministrinë e Punëve të Jashtme- Drejtorinë e Migracionit krejtësisht të lirë të vendosë për çdo rast të vetë veçantë.

Megjithatë, janë vendosur disa udhëzime për të pavarurit/të vetëpunësuarit. Këta punëtorë kanë të drejtë për bashkim familjar pas tre vjetësh në Luksemburg. Nëse një i mitur në ngarkim është 17 vjeç, mund të ketë probleme sepse procedura mund të zgjasë përtej 18 vjetorit të tij/saj, pas të cilës ai nuk konsiderohet me fëmijë. Prindërit e migrantit mund të pranohen vetëm nëse kanë kaluar moshën e lejuar për punë.

8. Sistemi i kujdesit shëndetësor

Të gjithë punëtorët dhe familjet e tyre mbulohen nga sistemi i kujdesit shëndetësor. Në Luksemburg ka 3 doktorë për 1000 banorë. Një vizitë në GP kushton 31 euro. Kostoja e trajtimit mjekësor dhe shërbimeve (një doktor që zgjidhni vetë, spital) rimburohet sipas tarifave zyrtare.

Spitalet lokale ndodhen në Fletët e Verdha, por do të ishte më mirë të pyesni GP tuajin, farmacistin ose klubet e gjuhës angleze dhe burime të tjera në zonën tuaj të qëndrimit, pasi ata do të mund t'ju thonë cilët spitale kanë shërbime urgjence dhe si funksionojnë ato.

Në Luksemburg kujdesi në spital përgjithësisht është shumë i mirë edhe pse praktikat mund të ndryshojnë nga ato në vendin tuaj. Në shumicën e rasteve, shtrimi në spital duhet të rregullohet nga GP juaj dhe mund të ketë një listë pritjeje për disa trajtime dhe shërbime jo urgjente.

Në Dukat nuk ka spitale private. Të gjithë spitalet drejtohen nga *Caisse de Maladie* e shtetit dhe të gjitha pranimet jo urgjente në spital duhet të rregullohen nga doktori juaj. Ka tre kategori shërbimi, kategoria e parë, e dytë dhe e tretë. Kategoria e parë do të thotë të keni dhomë private dhe zakonisht duhet të paguani kosto shtesë nëse nuk keni premium siguracioni privat për shëndetin (pra shumë të shtrenjta). Kategoria e dytë, normalisht ndani një dhomë me dy ose tre pacientë, është shërbimi standard dhe mbulohet nga shumica e skemave të sigurimit në Luksemburg. Shërbimi i kategorisë së tretë përbëhet nga një pavion, zakonisht me më shumë se tre pacientë dhe ofrohet vetëm nën disa rrethana.

Të huajt që vijnë të jetojnë në Luksemburg pa punuar përgjithësisht duhet të japin një vërtetim të sigurimit të shëndetit për të marrë një leje qëndrimi. Ka plane të veçanta për sigurimin shëndetësor, të vlefshme në disa vende, të projektuara në mënyrë specifike për nevojat e të çatdhesuarve dhe atyre që udhëtojnë shpesh. Nëse kualifikoheni për statusin e 'jo-rezidentit', mund të mos ju kërkojnë të kontribuoni në sigurinë shoqërore kombëtare, dhe në këtë rast ndoshta do të mbuloheni nga plani i kujdesit shëndetësor të punëdhënësit tuaj.

Numri i telefonit për urgjencat mjekësore në Luksemburg është 112.

Më shumë informacion për sistemin e kujdesit shëndetësor në Luksemburg në:

<http://www.justlanded.com/english/Luxembourg/Topics/Health>

9. Sistemi i sigurimeve shoqërore

Të huajt e punësuar dhe të vetëpunësuar

Sistemi i sigurimeve shoqërore të Luksemburgut siguron mbrojtje për pesë situata të mundshme:

- sëmundje/shtatzëni (përfshirë varësinë)
- aksident në punë dhe sëmundje profesionale
- vjetërsi/invaliditet dhe mbijetesë
- përgjegjësi familjare
- papunësi

Sipas legjisllacionit aktual në Luksemburg, të gjithë personat e punësuar dhe të vetëpunësuar janë automatikisht të pranueshëm në sistemin e sigurimeve shoqërore. Në mënyrë tipike, përfitimet mbulojnë dhe anëtarët e familjes dhe madje disa persona që nuk janë anëtarë familjeje në rrethana të caktuara siç janë *au pair*. Studentët, ndihmësit dhe trajnuesit kanë kushte dhe rregulla të veçanta në lidhje me pranueshmërinë nëse nuk janë nën prindërit e tyre. Nëse merrni përfitime papunësie ose paaftësie apo pension vjetërsie atëherë do të vazhdoni të trajtoheni sipas sigurimeve shoqërore. I vetmi paralajmërim është që kontributet e punëdhënësit dhe punëmarrësit zbriten nga përfitimet që do të merrni meqenëse nuk punoni.

Pranimi: Deklaratat e hyrjes dhe daljes duhet t'i dërgohen seksionit të Qendrës së Përbashkët të Sigurimeve Shoqërore. Formalitetet plotësohen nga punëdhënësi. Punëmarrësi nuk ka nevojë të bëjë ndonjë gjë. Punëtorët e vet punësuar kontaktojnë qendrën dhe bëjnë deklaratat e tyre për t'u bashkuar/larguar nga skema.

Parimi i pranimit unik: Përfituesi nuk mund t'i përkasë më shumë sesa një fondi për sëmundje apo pension.

Kontributet: kontributet paguhen nga Qendra e Përbashkët e Sigurimeve Shoqërore. Si punëdhënësi ashtu dhe përfituesi kontribuojnë dhe shuma e paguar përfaqëson një përqindje të të ardhurave nga punësimi fitimprurës. Kontributet e përfituesit fillimisht shkojnë për sigurim shëndeti-shtatzënie, varësie dhe pensioni, por jo për sigurim në raste aksidenti, ndihmë ekonomike dhe përfitime papunësie.

10. Strehimi

Kostoja e strehimit në Luksemburg pasqyron nivelin e përgjithshëm të mirëqenies që ka Dukati, dhe ambientet me qira mund të gjenden me vështirësi, sidomos në kryeqytetin Luksemburg. Shumë nga punëtorët e Dukatit (më shumë se gjysma në fakt) udhëtojnë çdo ditë për të ardhur në punë nga vende fqinje Belgjikë, Francë ose Gjermani, ku kostoja e strehimit është përgjithësisht më e ulët.

Nëse do të vini të jetoni në Luksemburg për më pak se pesë vjet, ndoshta do të mësoni që marrja me qira- dhe jo blerja—është zgjidhja më e lehtë (dhe në disa raste, më ekonomike).

Prona e marrë me qira në Luksemburg mund të jetë e vështirë të gjendet sidomos menjëherë, dhe përgjithësisht qiratë janë të larta. Komuniteti i të çatdhesuarve është burim i mirë informacioni për shtëpi dhe apartamente me qira, sidomos nëse doni të shmangni tarifën e agjencive shtetërore që shkojnë sa dy ose tre qira mujore. Agjencitë e pasurive të paluajtshme janë të hapura vetëm në orare të kufizuara dhe shpesh në fundjavë nuk hapen fare. Nëse nuk përdorni agjenci, sigurohuni të mbani shënim pronat që keni parë; nëse shikoni të njëjtën pronë dy herë me agjenci të ndryshme dhe vendosni ta merrni me qira, mund të përfundoni duke paguar tarifën për dy agjenci. Për fat të keq, nuk mund të gjeni shtëpi me qira (ose për ta blerë) në Luksemburg me "gjueti tabelash" sepse pronarët zakonisht nuk vendosin tabela për pronat në dispozicion.

Pjesa më e madhe e pronave në Luksemburg jepen me qira të pamobiluara. Nëse shikoni një shtëpi ose apartament para se të dalin qiramarrësit e vjetër, mund të bini dakord që të blini pajisjet dhe pjesët e palëvizshme të tyre. Qiramarrjet e mobiluara janë në dispozicion (me qira më të larta). Nëse merrni me qira një pronë të mobiluar, sigurohuni që të kuptoni kush është përgjegjës për të siguruar mobilimin.

Gjetja e akomodimit

Ka mënyra të ndryshme për të gjetur një pronë me qira, përfshirë sa më poshtë:

Kërkojuni miqve, të afërme dhe të njohurve të kërkojnë për akomodim të përshtatshëm, sidomos nëse kërkonin në zonën ku keni jetuar tashmë. Shumë prona me qira gjenden duke kaluar njëri pas tjetrit, sidomos në qytete me popullsi të mëdha të të çatdhesuarve apo kalimtare.

Shihni reklamën në gazeta lokale (përfshirë dhe ato falas) dhe revistat.

Vizitoni agjentët e akomodimit dhe qiradhënies. Shumica e qyteteve të mëdha kanë agjentë të pasurive të paluajtshme (agjenci imobiliare) që veprojnë gjithashtu si agjentë qiradhënës për pronarët. Është më mirë të merreni me një agjent sesa direkt me pronarë, sidomos në lidhje me kontratat dhe çështjet ligjore.

Shikoni reklamën në vitrinat e dyqaneve dhe në tabela njoftimesh të qendrave tregtare, supermarketeve, universiteteve dhe kolegjeve dhe zyrave të kompanive.

Lexoni njoftimet e botuara nga kishat, klubet dhe organizatat e të çatdhesuarve dhe pyesni në shkollat ndërkombëtare ose vende të tjera ku mbledhen të çatdhesuarit dhe familjet e tyre.

Faqe të nevojshme interneti

- Departamenti i Strehimit - Info'logement

Siguron lloje të ndryshme të ndihmës financiare për ndërtim, blerje dhe rinovim të shtëpive. Në 2003, një agjenci për kërkim strehimi u krijua për të lehtësuar planifikimin e ndërtimit të shtëpive në Luksemburg.

www.logement.lu

- Luxweb

Një listë gjithëpërfshirëse e agjencive duke përdorur <http://luxëeb.lu/> web site. Faqja e saktë është <http://editusnet.lu/luxweb/neosearchAI.do?idThe=360&lan=AN&numRub=600>

- Immonews

Faqe interneti Generic me mundësi kërkimi për të plotësuar kërkesat individuale:

<http://www.immonews.lu/>

- Gazetë lokale e Luksemburgut

<http://wort.lu/>: në rubrikën në të majtë, në kutinë Anzeigen zgjidhni Immobilien. Megjithatë për të lexuar njoftimet mund të duhet të kuptoni frëngjisht dhe/ose gjermanisht.

- RTL

<http://www.rtl.lu/service/immobilien/athome/>.

Gjithçka që duhet të dini përpara se të firmosni një kontratë qiraje

Sapo të gjeni një shtëpi ose apartament për ta marrë me qira, do të duhet të negocioni dhe të përfundoni një kontratë qiraje. Duhet të lexoni me kujdes kontratën e qirasë përpara se ta firmosni dhe, nëse keni dyshime apo pyetje për ndonjë term, kërkoni t'ua përkthejnë ose shpjegojnë.

Një kontratë qiraje do të identifikojë pronën që po merrni me qira, duke përfshirë adresën e rrugës dhe apartamentin (ose me numër ose vendndodhje). Nëse ka dhoma ose lehtësira shtesë të përfshira në qiranë bazë, si akses në një lavanteri, garazh, vend parkimi apo ambiente magazinimi, këto duhet të shënohen në kontratën e qirasë. Nëse do të merrni një ambient gjysmë të mobiluar ose pjesërisht të mobiluar, kjo duhet të shënohet si dhe të tregohet cilat pajisje ose pjesë të palëvizshme janë përfshirë.

Një kontratë tregon shumën e qirasë mujore, datën që duhet paguar dhe mundësisht mënyrën e pagimit (shumë pronarë kërkojnë të vendosin një porosi të përhershme në bankë), si dhe gjoba për pagesë të vonuar. Duhet të përfshijë gjithashtu detaje të rritjes së qirasë mujore që zakonisht indeksohen, si dhe procedurën për rritjen e qirasë mbi këtë shumë.

Kontrata e qirasë duhet të përfshijë shumën dhe kushtet e depozitës së dëmeve. Kur të largoheni, pritet që shtëpinë ose apartamentin ta ktheni në gjendjen që ishte kur e morët; nëse nuk e bëni këtë gjë, pronari i shtëpisë mund të përdorë depozitën tuaj për të mbuluar koston e riparimeve të nevojshme. Depozita zakonisht do të mbahet deri në përcaktimin dhe shlyerjen e detyrimeve të fundit të përbashkëta, kështu që mund të jetë një vit ose më shumë pasi të keni ikur përpara se të merrni depozitën.

Një kontratë standarde qiraje në Luksemburg është shkruar për një afat të caktuar prej tre vjetësh. Nëse jeni me një detyrë për kohë të shkurtër, mund të kërkoni për një ose dy kontrata ose të përfshini në marrëveshje standarde qiraje një klauzolë diplomatike. Zakonisht ju kërkohet të njoftoni me shkrim tre muaj përpara prishjes apo përfundimit të kontratës së qirasë.

Detyrimet e përbashkëta, rregullat e brendshme dhe inventari

Detyrimet e përbashkëta janë tarifata mujore që paguani për shërbimet që ndani me fqinjët në të njëjtën ndërtesë (ose ndonjëherë brenda të njëjtit kompleks apo pronës së paluajtshme të strehimit)

Çdo muaj, ju kërkohet të paguani një shumë të vlerësuar kundrejt mirëmbajtjes dhe riparimit të zonave të përbashkëta (p.sh korridore, salla, kate të para, ashensorë) koston e portierit ose menaxherit, furnizimin me ujë dhe kanalizimet dhe shërbime të tjera publike të përbashkëta, përfshirë ngrohjen dhe ujin e nxehtë nëse këto sigurohen për komunitetin.

Detyrimet e përbashkëta i shtojnë 10-20 përqind qirasë bazë, sipas asaj që mbulohet dhe mënyrës së shpërndarjes. Kur dilni nga apartamenti, është e zakonshme që pronari të mbajë depozitën për dëme deri në shlyerjen e detyrimeve të përbashkëta të fundit, që mund të zgjasin një vit ose më shumë. Vini re që në Luksemburg nuk ka shoqata për qiramarrësit ose pronarët ku mund të bëni pjesë për të thënë sa jeni të detyruar të paguani.

Shumë blloqe apartamentesh kanë **rregullat e brendshme** disa prej të cilave mund të formulohen nga komuna lokale dhe të zbatohen me ligj. Duhet të merrni një kopje të rregullave të brendshme për t'ua zhvendosur në një apartament ose kur firmosni një kontratë qiraje ose shitjeje, por është mirë t'i shikoni përpara se të bini dakord për të marrë me qira ose të blini një shtëpi, pasi mund të

ndikojnë në përdorimin e ambienteve të përbashkëta (ndonjëherë ata do të kufizonin dhe ngjyrën e perdeve të dritareve). Nëse nuk i kuptoni rregullat, kërkoni t'ua përkthejnë; mosdija nuk është justifikim për të shkelur rregullat e brendshme.

Një nga detyrat më të rëndësishme për t' u zhvendosur në një apartament ose shtëpi të re është të përfundoni një raport **inventari** dhe gjendjeje (état des lieux). Kjo përfshin gjenden e pajisjeve të palëvizshme dhe mobilie (nëse ka), pastërtinë dhe gjendjen e dekorimeve dhe objekte që mungojnë ose kanë nevojë për riparim.

11. Njohja e diplomave të huaja

Një Departament për njohjen e diplomave është pjesë e Ministrisë së Arsimit dhe Trajnimit Profesional.

Departamenti kryen detyrat e mëposhtme:

- pret dhe jep informacion në lidhje me njohjen e diplomave;
- përgatit njohjen e diplomave, certifikatave dhe kualifikimeve të huaja;
- merr pjesë në përshtatjen e direktivës së ardhshme europiane në lidhje me njohjen dhe kualifikimet profesionale me të drejtën e Luksemburgut;
- publikon dokumentacionin (në formë libri dhe në internet) për procedurat e njohjes;
- krijon një bankë të dhënash për diploma të huaja që lejon zbulimin e dokumenteve të rreme;
- jep informacion për dokumentet *europass*;
- përfaqëson ministrinë në administrata të tjera dhe Komisionin Europian në lidhje me njohjen e diplomave.

Ky departament punon ngushtë me departamentet e Ministrisë për arsimin shkollor parësor dhe dytësor, për trajnimin profesional dhe për shkollimin e fëmijëve të huaj
Zyra e pritjes (zyra nr 006) ndodhet në katin e parë të ministrisë.

Si të paraqisni një kërkesë për njohjen e diplomës?

Të gjitha kërkesat duhet të paraqiten me shkrim në Ministrinë e Arsimit dhe Trajnimit Profesional. Njohja do të bëhet vetëm në bazë të aplikimeve të plotësuara duke përfshirë dokumentet e mëposhtme:

- Një kërkesë me shkrim që përmban arsyet për kërkesën tuaj
- Një fotokopje të noterizuar të diplomës/certifikatës origjinale ose një fotokopje të noterizuar të listës origjinale të notave të dy viteve të fundit
- Një fotokopje të noterizuar të kartës së identitetit
- Një përmbledhje të karrierës shkollore
- Një dëshmi penaliteti (vetëm për mësuesit)

Të gjitha fotokopjet e diplomave, certifikatave dhe listave të shkollës si dhe karta e identitetit duhet të noterizohen nga një autoritet që e ka këtë të drejtë siç janë administrata komunale, ambasada ose konsullata.

Dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë në frëngjisht, gjermanisht ose luksemburgisht, tre gjuhët zyrtare të Luksemburgut ose të përkthyer në një nga këto tre gjuhë nga një përkthyes zyrtar në Luksemburg (një listë e përkthyesve të licencuar ndodhet në Gjykatën e Drejtësisë - (+352) 47 59 81-1). Vula e përkthyesit duhet të vihet pjesërisht në tekstin e përkthyer dhe pjesërisht në dokumentin e paraqitur për përkthim. Të gjitha dokumentet duhet të firmosen nga përkthyesi.

12. Shërbimet mbështetëse për Migrantët

Kurse gjuhe

Nëse jeni në gjendje të komunikoni në gjuhën e Luksemburgut, gjermanisht dhe/ose frëngjisht do t'ju japë mundësi të përfitoni sa më shumë nga jetesa në Luksemburg. Programet e qeverisë ofrojnë kurse gjuhe, që përfshijnë edukatën qytetare për t'ju ndihmuar që të përgatiteni për marrjen e shtetësisë.

Shihni për informacion për kurse dhe shkolla gjuhe në www.justlanded.com

OJQ-të

- ASTI është OJQ e bazuar në anëtarësim individual, aktive në veri të kryeqytetit Luksemburg dhe lufton për të drejta të barabarta për të gjithë banorët www.asti.lu
- Caritas është shumë aktiv në fushën e azilkërkuarve dhe refugjatëve: <http://www.caritas.lu/>
- CLAE është organizatë çadër që bashkon qindra organizata të të huajve. Ajo organizon festivale shumë kulturore, etj. www.clae.lu
- SESOPI është qendër kërkimore katolike, përgjegjëse për Luksemburgun për studimin e fundit të vlerave europiane www.restena.lu/sesopi-ci .
- Medecins sans Frontiers: <http://www.msf.lu/>

13. Shtetësia

Rreth 1000 të huaj marrin shtetësinë në Luksemburg çdo vit me anë të njërës nga dy rrugët e mundshme: "zgjedhje" ose natyralizim.

Nëse jeni nga mosha 18 deri në 25 vjeç, mund të "**zgjidhni**" për shtetësi nëse keni lindur në Luksemburg (dhe nuk keni marrë kombësinë nga një prej prindërve tuaj), keni përfunduar pjesën më të madhe të shkollimit atje ose jeni martuar me një shtetas të Luksemburgut. Duhet të leni jetuar në Luksemburg gjatë pesë viteve të shkuara dhe të keni pranuar të hiqni dorë nga shtetësia e mëparshme. Për t'u bërë shtetas me anë të **natyralizimit**, duhet të jeni mbi 18 vjeç, të keni jetuar në Dukat gjatë dhjetë viteve të fundit dhe të keni pranuar të hiqni dorë nga shtetësia e mëparshme. Më shumë informacion për marrjen e shtetësisë në Luksemburg gjendet në Ministrinë e Drejtësisë në kryeqytetin Luksemburg (+352) 478-4545).

14. Institucionet qeveritare përgjegjëse për imigracionin

Drejtoria e Imigracionit në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Është përgjegjëse për kërkesat për hyrjen dhe qëndrimin e të huajve.

Drejtoria është e hapur për publikun nga ora 8.30 deri në 11.00 nga e hëna në të premte. Mund të kontaktohet me telefon nga 14.00 deri në 16.00.

Ministère des Affaires étrangères et de l'Immigration

Direction de l'Immigration

12-16, avenue Monterey, L – 2163 Luxembourg

Tel.: (+352) 247-84040

<http://www.mae.lu/mae.taf?Idnav=1298&IdLang=FR>

Shërbimi Publik i Punësimit (L'Administration de l'emploi - ADEM) në Ministrinë e Punës dhe Punësimit
Është përgjegjës për shqyrtimin e lejeve të punës dhe lehtëson kërkimin për punë

10, rue Bender

L-1229 Luxembourg

Tél: +352 2478-5300
E-mail: info@adem.public.lu
<http://www.adem.public.lu/demandeur/index.html>

Ministria e Bizneseve të Vogla (Ministère des Classes Moyennes)

Përgjegjëse për lejet e punës për të vetëpunësuarit
6, boulevard Royal
L-2449 Luxembourg
+352 247-84715 / 247-84717 / 247-84718 / 247-84724
info@mcm.public.lu
Orari i punës: Nga e hëna në të premte nga ora 8.00-12.30

Ministria e Arsimit dhe Trajnimit Profesionale

Siguron informacion për migrantët që kërkojnë mundësi studimi ose trajnimi profesional. Ka gjithashtu një departament që merret me njohjen e diplomave
Ministère de l'Éducation nationale et de la Formation professionnelle
29, rue Aldringen
L-1118 Luxembourg
Tél.: (+352) 2478 51 00
E-mail: info@men.public.lu
Faqe interneti: <http://www.men.public.lu/>
* Departamenti për njohjen e diplomave http://www.men.public.lu/reco_diplomes/index.html

Ministria e Kulturës, Arsimit të Lartë dhe Kërkimit

Siguron informacion për migrantët që kërkojnë mundësi studimi në nivel universitar dhe pasuniversitar si dhe mundësi për kërkime.
Ministère de la Culture, de l'Enseignement Supérieur et de la Recherche
20, Montée de la Pétrusse
L-2273 Luxembourg
Tél: +352 478 1
Faqe interneti: <http://www.mcesr.public.lu/>

Ministria e Drejtësisë

Përgjegjëse për marrjen e shtetësisë/kombësisë
13, rue Erasme
L-2934 Luxembourg
Tél: +352 478-1
E-mail: info@mj.public.lu
Faqe interneti: <http://www.mj.public.lu/>